

## Politika ESG



**Data:** 07/12/2023

**Versioni:** 1.0

## Indeksi

<b>Parathënie</b> .....	3
Qëllimi.....	3
Zona e Zbatimit .....	3
Përditësimi, Rishikimi dhe Shpërndarja.....	4
<b>Ambienti</b> .....	5
Dekarbonizimi i proceseve dhe produkteve.....	5
Efikasiteti në përdorimin e energjisë dhe furnizimi nga burime rinovueshme .....	5
Menaxhimi i burimeve ujore .....	5
Përdorimi i materialeve .....	5
Menaxhimi i përgjegjshëm i mbeturinave.....	6
Ndikime të tjera .....	6
<b>Sociale</b> .....	7
Të drejtat e njeriut dhe kushtet e punës.....	7
Shëndeti dhe siguria e punonjësve.....	7
Mirëqenia në vendin e punës.....	8
Vlerësimi i kapitalit njerëzor.....	8
Përkushtimi për zhvillim territorial.....	8
<b>Qeverisja</b> .....	9
Krijimi dhe shpërndarja e vlerës ekonomike.....	9
Kënaqësia e klientëve.....	10
Certifikimet e sistemit HSQE.....	10
Kërkim dhe Zhvillim për Inovacionin e Produkteve .....	10
Zinxhiri i furnizimit të përgjegjshëm.....	11
<b>Konkluzionet</b> .....	11

## Parathënie

### Qëllimi

Në përmbushje të qëllimeve të objektit social të saj, Giobert S.p.A. (në vijim edhe "Kompania") ka vendosur të ndërmarrë - edhe në emër të shoqërive të Grupit Giobert (në vijim edhe "Grupi") - një qasje të përgjegjshme në aspektin ekonomik dhe etik, me qëllim të krijimit të vlerës qëndrueshme në kohë dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të performancave; në këtë drejtim, Drejtoria e Grupit është përgjegjëse për përhapjen e praktikave të mira mjedisore dhe sociale dhe për promovimin e një kulture biznesi të vetëdijshme për ndikimet e saj.

Nga pikëpamja operative, Grupi është i angazhuar përditësisht në kryerjen e aktiviteteve të veta në mbushje të plotë të ligjeve dhe të të gjitha detyrimeve të zbatueshme, duke siguruar në disa fusha konsultim dhe pjesëmarrje të punonjësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre, sipas modaliteteve të përcaktuara specifikisht.

Në përputhje me misionin e Grupit Giobert dhe me vlerat e përmendura në Kodin e Etikës, Kjo Politikë ESG, e frymëzuar nga Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 dhe nga principet e UN Global Compact:

- identifikon parimet themelore që Grupi ka angazhuar të ndjekë në veprimtarinë e vet dhe në marrëdhëniet me kategoritë e ndryshme të palëve të interesuara;
- drejton përcaktimin e iniciativave dhe objektivave të performancës në fushën ESG, të cilat janë kohë pas kohë subjekt i vendimeve të korporatave kompetente.

### Zona e Zbatimit

Politika ESG e Grupit Giobert është përgatitur me respektimin e rregullave të përcaktuara nga Kodi i Etikës dhe Modeli i Organizatës, Menaxhimit dhe Kontrollit të Giobert S.p.A. (i përgatitur në përputhje me D. Lgs. 231/2001), si dhe të të gjitha procedurave dhe politikave të përcaktuara nga Grupi dhe shoqëritë individuale që bëjnë pjesë në Grupin (të quajtur "Shoqëritë").

Politika ESG zbatohet në të gjitha Shoqëritë e Grupit përmes përcaktimit periodik të objektivave specifike të qëndrueshmërisë, dhe bëhet e njohur klientëve, furnizuesve dhe bashkëpunëtorëve.

## **Përditësimi, Rishikimi dhe Shpërndarja**

Politika ESG, si edhe çdo ndryshim dhe/ose përmirësim i saj, miratohet nga Këshilli i Administratës i Giobert S.p.A.

Kjo Politikë përditësohet periodikisht në varësi të nevojave ligjore, strategjive të reja të biznesit ose në rast se kërkojnë ndryshime të kontekstit të brendshëm (procese korporatash, riorganizimet, ndryshimet në matriksin e rëndësisë) dhe të jashtëm (konteksti i qëndrueshmërisë, ndryshime të rëndësishme në sektorët e aktivitetit të pranishëm në Grup).

Këshilli i Administratës i Giobert S.p.A., me mbështetjen e Grupit të Punës për Qëndrueshmëri, monitoron dhe vlerëson përshtatshmërinë dhe konsistencën e Politikës ESG aktuale në raport me praktikën më të mira dhe principet aktuale, zbatimin efektiv operativ, si dhe nevojat për përditësim të saj.

Politika ESG është subjekt i një plani të veçantë komunikimi dhe trajnimit të korporatës, i menaxhuar nga Grupi i Punës për Qëndrueshmëri, me qëllim stimulimin e pranimin të sjelljeve proaktive dhe të përgjegjshme nga të gjithë të interesuarit (stakeholder) të Grupit Giobert dhe arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancave të qëndrueshmërisë.

Për sa i përket komunikimit të Politikës ESG, ky plan përfshin:

- përkthimi në të gjitha gjuhët e vendeve ku ndodhen kompanitë e Grupit dhe në gjuhën angleze;
- përcjellja e klientëve dhe furnizuesve në mënyrën e vlerësuar si më të përshtatshme, në terma të përmbajtjes dhe mjetit të komunikimit;
- publikimi në faqen e internetit dhe rrjetin intranet të kompanisë;
- vendosja në tabelat e njoftimeve të kompanisë të një dokumenti përmbledhës, i cili përmban të gjitha informacionet e nevojshme për kuptimin dhe zbatimin e saj;
- dërgimi i një letre të gjithë personelit, me nënshkrimin e Drejtorit Ekzekutiv, në lidhje me përmbajtjen dhe modalitetet e informimit/formimit të parashikuara brenda Grupit;
- dorëzimi punonjësve të rinjë, së bashku me dokumentacionin e parashikuar gjatë periudhës së punësimit, të një "paketë" informuese, duke përdorur edhe postën elektronike, për të siguruar njohuritë që konsiderohen si të rëndësishme për ta.

Për sa i përket trajnimit të korporatës, ky plan parashikon ndërhyrje të ndryshme në varësi të grupit të synuar, me një qëllim të personalizimit të rrugëve dhe përgjigje reale ndaj nevojave të strukturave/ burimeve individuale. Në përgjithësi, parashikohen module trajnimit të përgjithshëm dhe module trajnimit të specializuar dhe të fokusuar për secilën fushë të cilën e vlerësojmë si strategjike për angazhimin në zhvillimin e qëndrueshëm.

## Ambienti

Grupi Giobert promovon mbrojtjen e mjedisit duke respektuar ligjet e përcaktuara dhe angazhohet të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta dhe të pasqyruara të aktiviteteve të veta në periudhë të shkurtër dhe të gjatë, duke përmirësuar vazhdimisht performancën e vet me një vëmendje të veçantë për këto fusha.

### **Dekarbonizimi i proceseve dhe produkteve**

Ne angazhohemi - përmes një monitorimi të vazhdueshëm dhe zgjedhjeve specifike strategjike - për të raportuar dhe zvogëluar emetimet e gazeve serrë, që rrjedhin nga aktivitetet tona operative në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe tërthorazi, dhe për të ofruar produkte të qëndrueshme në një perspektivë të Analizës së Ciklit të Jetës.

Në këtë kuptim, ndajmë qëllimin e zvogëlimit të emetimeve të gazeve serrë të përcaktuar në nivel evropian, për të arritur Neutralitetin Karbonike deri në vitin 2050 dhe zhvilluar një model prodhimi të qëndrueshëm.

### **Efikasiteti në përdorimin e energjisë dhe furnizimi nga burime rinovueshme**

Promovojmë një menaxhim të kujdesshëm të konsumit të energjisë për të arritur një përfitim dyfish nga zvogëlimi i kostos operative dhe reduktimin e emetimeve të pasqyruara të gazit serrë. Gjithashtu, mbështesim autonome dhe sigurinë energetike që vjen nga përdorimi i sistemeve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme dhe angazhohemi për të rritur përqindjen e vetë-prodhimit për të mbuluar konsumin tonë.

### **Menaxhimi i burimeve ujore**

Menaxhojmë me kujdes burimet e ujit në dispozicion tonë: ne angazhohemi të zvogëlojmë çdo rrezik uji duke monitoruar vazhdimisht cilësinë e ujrave të shpërndara në raport me kërkesat normative specifike dhe duke përdorur mënyra efikase dhe të përgjegjshme të përdorimit.

### **Përdorimi i materialeve**

Promovojmë një përdorim të përgjegjshëm të burimeve natyrore - duke u angazhuar për të zvogëluar në minimum dhe ri-përdorur mbeturinat e lëna pas nga aktivitetet tona prodhuese dhe për të nxitur një ndërgjegjësim zinxhir në këtë drejtim - dhe mbështesim tranzicionin drejt një ekonomie ciklike, me qëllim eliminimin e konceptit të mbeturinave përmes përdorimit të materialeve të qëndrueshme për mjedisin.

Ne angazhohemi gjithashtu për një furnizim të qëndrueshëm të materialeve, me qëllim për të garantuar një menaxhim të përgjegjshëm të burimeve natyrore, në veçanti pyjet, dhe mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve.

### **Menaxhimi i përgjegjshëm i mbeturinave**

Kontrollojmë me kujdes substancat kimike të përdorura dhe sasi të mbetjeve të gjeneruara nga aktivitetet tona operative, duke zbatuar principe të zvogëlimit, riciklimit, ri-përdorimit dhe rikuperimit në proceset prodhuese që kryejmë. Për këtë arsye, kemi zhvilluar sisteme menaxhimi mjedisor që na lejojnë të përmirësojmë vazhdimisht performancën tonë, duke garantuar zbatueshmërinë normative dhe duke zvogëluar rrezikun e ndotjes në lidhje me të gjitha matrikat mjedisore (ujë, ajër, dhe toke).

### **Ndikime të tjera**

I kushtojmë vëmendje çështjeve të ndotjes së ajrit dhe zhurmës, duke monitoruar vazhdimisht përmbushjen e kërkesave të veçanta ligjore në këtë fushë dhe duke zbatuar, kur është e mundur, praktikën më të mirë lidhur me to.

## Sociale

Grupi Giobert promovon mbrojtjen e të drejtave të punonjësve në zinxhirin e saj të vlerave, duke u angazhuar të zvogëlojë ndikimet sociale direkte dhe indirekte të aktiviteteve të saj në periudhë të shkurtër dhe të gjatë, duke u kujdesur posaçërisht për këto fusha.

### **Të drejtat e njeriut dhe kushtet e punës**

Ne sigurojmë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe respektimin e detyrimeve ligjore, duke siguruar një menaxhim të përgjegjshëm të marrëdhënieve me punonjësit dhe duke kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve të mëposhtme:

- kushtet e punës, përfshirë sigurinë në punë, orarin e punës, paga të përshtatshme, dialogun social, lirinë e bashkëpunimit, mundësinë e marrëveshjes kolektive;
- trajtim të barabartë, mundësi, pagë dhe trajnim, përfshirje;
- përfshirje, barazi gjinore, menaxhim i ndryshimit dhe diskriminimit në vendin e punës;
- kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar.

Në këtë kuptim ne promovojmë zbatimin e praktikave në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

### **Shëndeti dhe siguria e punonjësve**

Ne mbrojmë integritetin fizik të punonjësve tanë, duke u angazhuar për të zhvilluar një mjedis të shëndetshëm, të sigurtë dhe në përputhje me rregulloret aktuale, përmes:

- analizave e proceseve prodhuese për projektimin e vendeve të punës ergonomike;
- trajnimeve për përdorimin korrekt dhe të sigurt të makinerive dhe instalimeve, si dhe të manipulimit të substancave kimike;
- shpërndarjes dhe rishikimit të vazhdueshëm të pajisjeve mbrojtëse;
- trajnimeve për parandalimin e aksidenteve, sëmundjeve profesionale dhe menaxhimit të situatave të emergjencës dhe aksidenteve;
- përgatitjes dhe rishikimit të vazhdueshëm të sistemeve kundër zjarreve.

Në këtë kuptim, janë parashikuar role specifike, proceset, përgjegjësitë dhe momentet e konsultimit dhe pjesëmarrjes së punonjësve dhe/ose përfaqësuesve të tyre, dhe janë adoptuar praktikatat më të mira të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

## **Mirëqenia në vendin e punës**

Kushtojmë vëmendje mirëqenies së punonjësve tanë, në vendin e punës dhe në jetën private: ndërmjet politikave dhe procedurave specifike, angazhohemi për të siguruar një mjedis pune të shëndetshëm, motivues, me barazi, fleksibël dhe përfshirës, si dhe për të garantuar benefitet adekuate.

## **Vlerësimi i kapitalit njerëzor**

Ne vlerësojmë kapitalin tonë njerëzor duke stimuluar mbrojtjen dhe zhvillimin e aftësive dhe kompetencave: në këtë mënyrë, përfshijmë burimet tona në rrugëtimet e rritjes profesionale, organizojmë rregullisht aktivitete trajnimi në të gjitha nivelet organizative dhe vlerësojmë vazhdimisht performancën e punonjësve, për të identifikuar mundësi për përmirësime.

## **Përkushtimi për zhvillim territorial**

Kontribuojmë në zhvillimin e territoritë cilit i përkasim, jo vetëm në terma të shpërndarjes së vlerës ekonomike të krijuar, por edhe në terma të krijimit të lidhjeve dhe mundësive për rritje kolektive: për këtë arsye, angazhohemi për të zhvilluar bashkëpunime dhe nismëra me komunitetin tonë referues, për të promovuar zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të tij.



## Qeverisja

Sistemi i Qeverisjes së Grupit Giobert synon të maksimizojë vlerën e krijuar në një periudhë afatmesme-gjatë dhe transparencën ndaj tregut, duke respektuar rregullat e vendeve ku Grupi vepron dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin e Etikës dhe me procedurat e brendshme.

Në veçanti, përmes shpërndarjes dhe zbatimit të Kodit të Etikës (i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit [www.giobert.com](http://www.giobert.com)), Grupi monitoron çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin etik dhe të përgjegjshëm të biznesit, si:

- korrupsioni dhe pastrimi i parave;
- mbrojtja e pronësisë industriale dhe intelektuale;
- trajtimi dhe mbrojtja e informacioneve të fshehura;
- menaxhimi i konflikteve të interesit;
- raportimi korrekt i informacioneve financiare;
- konkurrenca e ndershme;
- raportimi i sjelljeve të paligjshme.

Gjithashtu, si dëshmi e përkushtimit në fushën e qeverisjes në lidhje me menaxhimin e aspekteve ESG, Grupi është pajisur me:

- një Model i organizatës, menaxhimit dhe kontrolleve sipas Ligjit 231/2001, i adoptuar nga Giobert SH.P.K;
- një *Grup Pune i Qëndrueshëm* i përbërë nga Menaxherët e Grupit të çdo funksioni korporativ, Menaxherët e Sistemeve të menaxhimit dhe Menaxherët e Impianteve të kompanive të kontrolluara, me detyrën për të ndihmuar Këshillin e Administratës në aktivitetet operative, propozuese dhe konsultative në çështjet e qëndrueshmërisë të lidhura me operimin e aktivitetit të ndërmarrjes dhe të ndërmarrjeve të saj dhe për përgatitjen e strategjive, duke përfshirë analizën e temave të rëndësishme, për gjenerimin e vlerës në terma afatgjatë.

Së fundi, vëmendja e Grupit Giobert ndaj dimensionit të qeverisjes synohet në fushat e mëposhtme.

## **Krijimi dhe shpërndarja e vlerës ekonomike**

Krijimi i vlerës ekonomike dhe ekuilibri financiar janë kushte të domosdoshme për të garantuar zhvillimin e veprimtarive tona: prandaj ne operojmë, për të arritur performanca

ekonomiko/financiare të kënaqshme, gjithashtu për të kompensuar në mënyrë adekuate rrezikun e marrë nga aksionarët dhe për të gjeneruar vlerë shtesë për t'ua shpërndarë palëve tona të interesit.

## **Kënaqësia e klientëve**

Punojmë për të garantuar kënaqësinë e plotë e klientëve tanë, duke garantuar cilësi, disponueshmëri dhe bashkëpunim: falë sistemit tonë të veçantë të menaxhimit të cilësisë, ne mund të sigurojmë që metodat tona të punës janë në përputhje me standardet kryesore të referencës për cilësinë e automjeteve, si dhe me kërkesat specifike të shprehura nga klientët tanë; sistemi monitoron vazhdimisht produktet dhe shërbimet e ofruara, duke verifikuar performancën tonë dhe çdo çështje kritike me synim për një përmirësim të vazhdueshëm.

## **Certifikimet e sistemit HSQE**

Dëshirojmë të arrijmë përsosmëri në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve, duke mbrojtur në të njëjtën kohë punonjësit tanë dhe mjedisin: për këtë arsye, kemi implementuar sisteme të menaxhimit në lidhje me temat e cilësisë, shëndetit, sigurisë në punë, dhe mjedisit, në mënyrë që të monitorojmë të gjitha proceset e kompanisë; gjithashtu, po vlerësojmë aplikimin e sistemeve të reja të menaxhimit për të forcuar kontrollin e proceseve të kompanisë dhe për të përmirësuar performancën e qëndrueshme.

## **Kërkim dhe Zhvillim për Inovacionin e Produkteve**

Duke pasur parasysh rëndësinë e aftësisë për të inovuar vazhdimisht gamën e produkteve të ofruara në sektorët në të cilët operojmë, investojmë periodikisht burime të konsiderueshme për veprimtarinë e Kërkimit dhe Zhvillimit (R&D) dhe inovacionit, në mënyrë që të parashikojmë dhe të plotësojmë nevojat e klientëve dhe të sigurojmë zhvillimin dhe suksesin e biznesit tonë; angazhohemi për të fituar njohuri të reja duke promovuar shpërndarjen e tyre brenda organizatës dhe për të zgjeruar portofolin e klientëve dhe produkteve me synimin e një rritjeje të qëndrueshme të Grupit në terma afatgjatë.

## Zinxhiri i furnizimit të përgjegjshëm

Bashkëpunojmë në mënyrë aktive me zinxhirin tonë të furnizimit për të promovuar adoptimin e sjelljeve shoqërore të përgjegjshme dhe për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të punonjësve, si dhe respektimin e mjedisit.

Në këtë drejtim, inkurajojmë dhe monitorojmë periodikisht përkushtimin e furnizuesve dhe nënkontraktorëve tanë në përputhje me të gjitha principet themelore të përcaktuara në këtë Politikë ESG, duke dialoguar vazhdimisht dhe promovuar zbatimin e praktikave në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare në këtë fushe.

## Konkluzionet

Në qendër të këtij projekti dhe forca shtytëse thelbësore për ta konkretizuar janë të gjithë individët që përbëjnë grupin tonë.

Për të arritur objektivat ambicioze që Grupi Giobert vendos me anë të kësaj politike, janë të domosdoshme njohuria, ndarja dhe respektimi i principeve të shpallura këtu.

Për të gjithë ne është detyra jonë të promovojmë një kulturë korporative që nxit rritjen dhe përsosmërinë duke respektuar etikën, qëndrueshmërinë dhe respektin për njerëzit.

**Giobert S.p.A.**

**Kryeshefi Ekzekutiv**

**Paolo Bertolino**



Miratuar nga Këshilli i Administratës më datë 07/12/2023.

Translated from Italian by	Verified by	Approved by
Eglana Ceka 	Chief accountancy officer Ada Belba 	CEO Claudio Fusero 